

Paketa e testimit për COVID-19 në shtëpi

Testohuni dhe ndihmoni të mbronni të gjithë njujorkezët! NYC Health + Hospitals po ju jep një paketë testimi në shtëpi të COVID-19 për familjen tuaj.

Cilido që rezulton pozitiv për COVID-19 ose që ka qenë në kontakt me dikë që ka pasur COVID-19, duhet të vijojë të qëndrojë i veçuar nga të tjerët derisa monitori juaj të tregojë se ju lejohet ta përfundoni izolimin. Nëse jeni testuar për COVID-10, ndajeni këtë paketë testimi në shtëpi për COVID-19 me familjen dhe miqtë.



Paketa e testimit për COVID-19 në shtëpi ka:

- Tamponin e hundës
- Tub plastik, i njohur dhe “tub solucioni stabilizues”
- Fletë udhëzimesh me një kod kuponi dhe kod aktivizimi
- Qese të njohur dhe si “qesja e mostrës”
- Pako postimi
- Ngjitëse për mbylljen
- Qesen e dërgimit me FedEx

Lexojini udhëzimet në kuti për përdorimin e paketës dërgoni mostrën tuaj dhe merrni rezultatet përkatëse.

Kujtesa për dërgimin:


Mos harroni ta dërgoni mostrën tuaj **brenda ditës** që regjistroni paketën dhe kryeni testin. **Mos e dërgoni testin pas ditës së fundit të marrjes apo gjatë fundjavave. Ju inkurajojmë gjithashtu të mos i bëni dërgesat të të premtëve.**

Paketën mund t’jua dorëzojë dhe një i afërmi juaj, ose mund të planifikoni që të vinë t’jua marrin në shtëpi.

Dorëzimi në vend: Kontrolloni oraret te [fedex.com/dropbox](https://www.fedex.com/dropbox) për të parë se kur bëhet marrja nga Federal Express për ditën përkatëse. Testin mund ta dërgoni në cilëndo pikë dorëzimi të FedEx Express. Ju rekomandojmë së tepërmi një pikë qendrore dërgimi të FedEx.

Marrja në shtëpi: Për të planifikuar marrje në shtëpi, telefononi **1-800-463-3339 (1-800-Go FedEx)**. Thoni ‘Schedule a Pickup’ (caktoni një marrje) ose shtypni ‘1’. Kur t’ju kërkohet një numër llogarie, jepni numrin e Return Tracking (gjurmimi i kthimit) në qesen tuaj të dërgimit të FedEx.

[Shikoni udhëzimet në pjesën e pasme >](#)



Please scan for English

Ju lutemi skanoni për shqip

يُرجى تصوير الرمز للغة العربية

অনুগ্রহ করে বাংলার জন্য স্ক্যান করুন

Veillez scanner pour la version en français

Tanpri eskane pou Kreyòl Ayisyen

कृपया हिंदी के लिए स्कैन करें

한국어로 스캔해 주십시오

Proszę sprawdzić wersję polską

Пожалуйста, сканируйте для русского языка

请扫描以获取简体中文版本

Escanee para español

請掃描以取得繁體中文版本


براہ مہربانی اردو کے لیے سکین کریں

NYC
HEALTH+
HOSPITALS

Test & Trace
Corps

Udhëzime

- Lexoni udhëzimet në fletën e paketës tuaj.
- Përpara se të filloni, regjistroni paketën në internet në adresën picturegenetics.com/covid19/group. Klikoni te **'I have a kit already.'** (Unë kam një paketë)
- Vendosni **kodin e kuponit** që ndodhet brenda paketës tuaj dhe **kodin e aktivizimit** që ndodhet në kapakun e përmes të fletës së udhëzimeve dhe klikoni **'Confirm Registration.'** (Konfirmo regjistrimin)
- Nëse ju kërkohet, zgjidhni që e keni marrë këtë paketë nga pakoja e përkujdesjes e qytetit të Nju-Jorkut.
- Lajini duart përpara dhe pasi të keni kryer testin.
- Mos e lani hundën përpara se të kryeni testin. Hundën mund ta fryni me shami të paaromatizuara.
- Hapni **tubin plastik** dhe vendoseni në një sipërfaqe të rrafshët për të marrë mostrën tuaj.
- Në vijim, hapni **tamponin e hundës**. Mos e lini të prekë asgjë përpara apo pas futjes në flegelat e hundës suaj.
- Shtyjeni me kujdes **tamponin e hundës** rreth një inç në flegrën e hundës derisa të cekë pjesën e sipërme të zgavrës së hundës. Rrotullojeni tamponin katër herë. Ky veprim nuk duhet t'ju shkaktojë acarim. Nxirreni tamponin me kujdes.
- Përsëriteni këtë hap në flegrën tjetër me të njëjtin tampon.
- Vendoseni **tamponin e hundës** në **tubin plastik** me pjesën e tamponit për poshtë (ana që futët në hundë).
- Thyejeni **tamponin e hundës** në vijën e pikëzuar; duhet të thyhet me lehtësi përgjysmë.
- Sigurohuni që **tamponi i hundës** të jetë në mes të tubit. Në vijim, mbylleni mirë **tubin plastik** dhe kontrolloni që të mos ketë pikim. Bëni kujdes të mos e mbyllni shumë fort.
- Vendoseni **tubin plastik** me **tamponin e hundës** brenda **qeses**.
- Vendoseni qesen në **pakon e postimit** dhe mbylleni me **ngjitësen e mbylljes**.
- Vendoseni **pakon e postimit** në **qesen e dërgimit me FedEx**. Ndiqni udhëzimet e dërgimit që ndodhen mbi paketën tuaj.
- Ruajeni **fletën e udhëzimeve** për dokumentacionin tuaj.



Mos harroni:

- Dërgojeni testin brenda ditës që regjistroni paketën dhe kryeni testin. Duhet të bëni dërgimin e testit brenda 24 orëve. Mos e dërgoni pas ditës së fundit të marrjes apo gjatë fundjavave. Ju inkurajojmë gjithashtu të mos e dërgoni të premtëve.
- Rezultatet do t'i merrni brenda 48 orëve pasi laboratorit të ketë marrë mostrën tuaj. Rezultatet do t'ju ofrohen përmes llogarisë në portalin Picture.

Duhet ta verifikoni llogarinë tuaj në Picture Genetics përmes emailit:

Kontrolloni kutinë e emailit për emailin e verifikimit nga [donotreply@picturegenetics.com]. Këto udhëzime dhe një video demonstrimi mund t'i gjeni te picturegenetics.com/nasalswab

Për mbështetje mund të kontaktoni me Picture Genetics me:

Email: hello@picturegenetics.com

Bisedë direkte: nga PictureGenetics.com

Telefon: **626-434-3596**, e hënë - e premte, 12 PM deri 7 PM EST

Faleminderit që e mbani të shëndetshëm qytetin e Nju-Jorkut! Rrini shëndetshëm.